REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 139/2 prot.

Elbasan, më 28.01.2020

VENDIM

Nr 02 date 28.01.2020

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM, NË NIVEL INSTITUCIONI, PËR MARRËDHËNIET ME STUDENTËT DHE KËSHILLIMIN E KARRIERËS"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, gërma "d", Statutit të UE-së, neni 9, gërma "d", me propozim të Komisionit të përhershëm, në nivel institucioni, për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.01.2020

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm, në nivel institucioni, për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e UE-së për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Skender TOPI

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM, NË NIVEL INSTITUCIONI, PËR MARRËDHËNIET ME STUDENTËT DHE KËSHILLIMIN E KARRIERËS NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI"
ELBASAN

Neni 1
Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm në Nivel Institucioni për Marrëdhëniet me Studentët dhe Këshillimin e Karrierës së Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (më poshtë UE) dhe marrëdhëniet e tij me strukturat e tjera të UE-së.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo Rregullore bazohet në nenin 46 të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e UE, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik të UE-së nr. 5 datë 30.01.2018 (neni 24), si dhe në aktet e tjera nënligjore apo Rregulloret e brendshme të UE-së.

Neni 3
Përkufizimi

Komisioni i Përhershëm në nivel Institucional dhe Njësie Kryesore është organ kolegjial që kryen funksionin e Mbrojtjes së Studentëve dhe cakton mënyrat e komunikimit me studentët, shënimin e problematikave dhe përcjelljen e tyre drejt organeve vendimmarrëse.

Neni 4
Përbërja e Komisionit

4.1 Komisioni i UE-së përbëhet nga shtatë anëtarë nga të cilët, 6 (gjashtë) janë anëtarë nga personeli akademik i UE-së, i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.

4.2 Anëtarët, përfaqësues të UE-së, vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 5
Funksionet e Komisionit

5.1.Komisioni i UE-së ka këto funksione kryesore:

a. Mbështet organet dhe autoritetet drejtuese të UE-së si dhe ofron ekspertizë në hartimin e politikave dhe procedurave për mbështetjen dhe mbrojtjen e studentit duke mbajtur në konsideratë mbledhjen e të dhënave nga studentët përmes Këshillave Studentore, pyetësorëve, raporteve vjetore në lidhje me problematikat e tyre si dhe referimin tek organet dhe autoritetet drejtuese të UE-së për zgjidhjen e tyre;
b. Bashkërendon komunikimin midis strukturave të ndryshme, veçanërisht kur procesi i delegohet fakulteteve ose kur ka një proces vlerësimi që është i organizuar nga Universiteti. Ky rol bashkërendues shtrihet në njësi të tjera në Universitet, kur procesi ka të bëjë me zhvillimin e personelit dhe mbledhjen/analizën e të dhënave institucionale;
c. Interpreton detyrimet kombëtare dhe evropiane të këshillimit të karrierës, në mënyrë që t'i përshtasë ato në kontekstin institucional. Kështu, anëtarët e Komisionit garantojnë që këto detyrime kombëtare dhe evropiane të njihen dhe të implementohen nga Universiteti;
d. Asiston në hartimin e pyetësorit dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit institucional të studentor për vlerësimin e brendshëm të cilësisë;

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI"
ELBASAN

e. Propozon masa për përmirësime të nevojshme që lidhen me garantimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe shkencore, bazuar në dokumentacionin dhe raportet periodike të Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t;
f. Miraton rregulloren e komisionit për garantimin e standardeve të cilësisë së njësisë kryesore dhe programeve të Studimit.
g. Miraton rregulloren e Komisionit të Përhershëm në Nivel Njësie Kryesore për Mbrojtjen e Studentëve;
h. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UE-së në kuadër të mbështetjes dhe mbrojtjes së studentëve.

Neni 6
Mbledhja e parë e Komisionit

6.1 Mbledhja e parë e Komisionit thirret nga Rektori, në cilësinë e Kryetarit të Senatit Akademik.
6.2 Mbledhja e parë e Komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.
6.3 Në mbledhjen e tij të parë Komisioni zgjedh, me votim të hapur, Kryetarin e tij me shumicë të thjeshtë votash të të gjithë anëtarëve të tij.
6.4 Çdo anëtar ka të drejtë të vetëpropozohet apo të propozohet nga anëtarët e tjerë për pozicionin e kryetarit.

Neni 7
Kryetari i Komisionit

Kryetari i Komisionit të UE-së kryen këto detyra:
1. Shpall rendin e ditës dhe njofton zyrtarisht strukturat përkatëse të UE-së për paraqitjen e materialeve sipas tematikës së miratuar;
2. Thërret mbledhjen e Komisionit në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe akteve të tjera nënligjore;
3. Drejton mbledhjen e Komisionit dhe siguron zbatimin e kuadrit ligjor në procesin e vendimmarrjes;
4. Nënshkruan aktet që miraton Komisioni;
5. Përfaqëson Komisionin e UE-së në veprimtari të tjera të UE-së.

Neni 8
Sekretari administrativ

7.1 Sekretari administrativ i Komisionit është pjesë e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t, në Rektoratin e UE.
7.2 Sekretari administrativ i komisionit kryen këto detyra:
a) Njofton zhvillimin e mbledhjes së Komisionit;
b) Njofton Kryetarin e Komisionit për pjesëmarrjen e anëtarëve në mbledhje;
c) Mban procesverbalin e mbledhjes së Komisionit;
d) Administron dhe ruan dokumentet zyrtare të Komisionit;
e) Kryen çdo funksion tjetër që i caktohet nga Komisioni në përputhje me përcaktimet e kësaj Rregulloreje.

Neni 9
Mbledhjet e Komisionit dhe thirrja e tyre

9.1 Si rregull Komisioni zhvillon mbledhje të paktën 1 herë në muaj.

9.2 Si rregull mbledhjet e Komisionit zhvillohen në ambientet e UE-së. Në rast se mbledhjet mbahen në një vend tjetër, ky tregohet në njoftimin e mbledhjes.

9.3 Kryetari i Komisionit vendos për thirrjen e mbledhjes së Komisionit.

9.4 Njoftimi i mbledhjes, u komunikohet anëtarëve të Komisionit të paktën 3 ditë kalendarike përpara datës së caktuar për mbledhjen. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes duhet të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet, orën dhe datën e zhvillimit të mbledhjes, si dhe duhet të shoqërohet me projekt vendimet dhe materialin argumentues.

9.5 Njoftimi për thirrjen e mbledhjes iu komunikohet anëtarëve të Komisionit në mënyrë elektronike nga sekretari administrativ.

9.6 Përveç mbledhjeve të zakonshme, çdo anëtar i Komisionit mund të marrë iniciativën për të kërkuar thirrjen e një mbledhje të Komisionit duke i dorëzuar Kryetarit një kërkesë me shkrim që përfshin agjendën dhe çështjet që do të jenë objekt i mbledhjes të paktën tre ditë përpara datës kur kërkohet mbledhja.

9.7 Kryetari brenda 24 orëve do të njoftojë më pas anëtarët e tjerë të Komisionit dhe Sekretarin për këtë takim dhe do të marrë masa për zhvillimin e mbledhjes së kërkuar jo më vonë se 2 ditë pune nga dërgimi i njoftimit anëtarëve të Komisionit.

Neni 10
Rendi i ditës

10.1 Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj, kryetari vendos për rendin e ditës së çdo mbledhjeje.

10.2Rendi i ditës duhet të përfshijë ato çështje që i janë propozuar atij nga Rektori i Universitetit "A. Xhuvani" Elbasan ose anëtarët e Komisionit me të drejtë vote dhe që janë në kompetencë të këtij organi.

10.3Kërkesa për të futur një çështje në rendin e ditës duhet të bëhet me shkrim, të paktën 3 ditë përpara datës së vendosur për mbledhjen.

10.4 Rendi i ditës duhet t'i shpërndahet të gjithë anëtarëve, të paktën 3 ditë përpara datës dhe kohës së mbledhjes.

Neni 11
Zhvillimi i mbledhjes dhe materialet e nevojshme

11.1 Në mbledhjet e Komisionit si rregull marrin pjesë anëtarët e Komisionit, sekretari administrativ, personeli ndihmësakademik i zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t që ka shqyrtuar e përpunuar një çështje të caktuar në rendin e ditës, si edhe çdo person tjetër që thirret nga Komisioni.

11.2 Në çdo rast të zhvillimit të mbledhjeve çështjet e përcaktuara në rendin e ditës së mbledhjes, duhet të kenë në dosjen personale materialin shoqërues si më poshtë:

- relacionin/informacionin argumentues;
- projekt-vendimin në rastet e propozimeve për vendim marrje;
-materiale të tjera të nevojshme për vendimmarrjen e Komisionit.

11.3 Për çdo mbledhje të Komisionit, sekretari i Komisionit do të mbajë procesverbalin e mbledhjes.
11.4 Proces-verbali i mbledhjes detyrimisht do të përmbajë informacion lidhur me vendin, kohën e fillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe ndryshimet e mundshme të ndodhura në të, anëtarët e Komisionit prezent ose që mungojnë, personat e tjerë të thirrur për të marrë pjesë të cilët janë prezent ose mungojnë, diskutimet e personave pjesëmarrës në mbledhje, rezultatet e votimit, konkluzionet e mbledhjes si dhe çdo informacion të diskutuar gjatë mbledhjes.
11.5 Procesverbali nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit që janë të pranishëm në mbledhje dhe nga sekretari administrativ.

Neni 12
Kuorumi

12.1 Mbledhja e Komisionit të Universitetit "A. Xhuvani" Elbasan, është e vlefshme kur janë të pranishëm me shumë se gjysma e anëtarëve te tij.

12.2 Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm shumica e anëtarëve, kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 ore pas së parës. Në këtë rast mbledhja është e vlefshme nëqoftëse janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve me të drejtë vote.

Neni 13
Forma e votimit dhe Marrja e vendimeve

13.1 Vendimet merren me votim te hapur.
13.2 Komisioni i UE-së merr vendime me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, me përjashtim të rasteve kur në ligj parashikohet ndryshe.
13.3 Komisioni i UE-së merr vendime me shumicë të të gjithë anëtarëve në rastin e miratimit të ndryshimeve të kësaj Rregulloreje.

Miratuar me vendim nr.__, datë 28.01.2020 të Senatit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" .

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN